

V E N D I M
Nr.9, datë 30.11.1994

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Feti Gjilani,	Zv/kryetar	i ""
Manol Konomi,	Anëtar	i ""
Franc Jakova,	Anëtar	i ""
Veli Budo,	Anëtar	i ""
Hilmi Dakli,	Anëtar	i ""

me sekretare Drita Filto, më datën 12.10.1994, 21.10.1994 dhe 30.11.1994, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.9 Akti, që i përket :

K E R K U E S V E: 1. GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE,
i përfaqësuar nga avokati Spartak Braho.
2. SELIM QAFLESHI
3. MARJETA VUKA

O B J E K T I

Shfuqizimi i nenit 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", sepse bije ndesh me dispozitat kushtetuese.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe :

- Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste :

1. Me shitjen nga shteti të ndërtesave që ka patur në pronësi, blerësit janë bërë pronarë duke e fituar atë në mënyrë të ligjshme, pa ekzistuar asnjë rrethanë që ta bëjë të pavlefshme kontratën e shitblerjes.

2. Blerësit e sotëm i kanë përdorur banesat për periudha të gjata duke qenë me mirëbesim sa që edhe pa lidhur kontrata shitblerjeje, do të ishin bërë pronarë me parashkrim.

3. Përmbajtja e nenit 10 të ligjit të lartpërmendur që vendos heqjen e pronësisë së shtëpive të pandryshuara të pronarëve të rinj në favor të ish-pronarëve, bije ndesh me dispozitën kushtetuese të ligjit "Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut", që parashikon se askujt nuk mund t'i mohohet e drejta të ketë pronë private vetëm ose me të tjerë".

- Qytetarët Selim Qafleshi dhe Marjeta Vuka :

Në shtëpitë e blera nga shteti kemi bërë shtesa e përmirësime të konsiderueshme dhe përfundimisht kërkojmë shfuqizimin e nenit 10.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës

V E R E N :

Në lidhje me shkakun e parë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Gjykata Kushtetuese çmon se ligjvënësi me nenet 1 e 4 të ligjit të sipërpërmendur ia ka njohur pronësinë ish-pronarëve edhe mbi shtëpitë e pandryshuara që nga data 29 nëntor 1944, duke shfuqizuar ato akte ligjore e nënligjore me të cilat shteti ka qenë bërë pronar pa të drejtë. Kështu marrja në këtë mënyrë nga shteti dhe shitja të tretëve, qoftë edhe sikur blerësi të ketë qenë në mirëbesim, nuk mund të prekë të drejtën e ish-pronarit që i është njohur që nga data 29 nëntor 1944. Të gjitha tjetërsimet që ka bërë shteti janë bërë me veprime juridike civile e megjithatë legjislatori për të ndrequr një padrejtësi, me ligj ia kthen pronën ish-pronarit të ligjshëm, duke parashikuar që edhe blerësi të mos dëmtohet. Për këtë, po në nenin 10 të ligjit sanksionohet kthimi i masës së shpërblimit sipas çmimit të shitjes në kohën e tjetërsimit, i konvertuar me indeksin e rritjes së çmimeve.

Edhe shkaku i dytë, se blerësi e ka përdorur shtëpinë e blerë për një kohë të gjatë me mirëbesim sa që edhe pa lidhur kontratë shitblerje do të ishte bërë pronar me parashkrim, në rastin konkret nuk qëndron. Kjo për arsye se dihej që shteti për shtëpitë që ka shitur, prejardhjen e pronësisë

e kishte nga një prej mënyrave të përmendura në nenin 1 që janë shfuqizuar dhe njohur si të paefektshme nga data 29 nëntor 1944. Kështu në rastin e nenit 10 nuk mund të ketë vend as për mirëbesim dhe as për parashkrim edhe për faktin se për parashkrimin e drejta e ish-pronarit i lindi të bëjë kërkesë vetëm pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Nuk qëndron as pretendimi i tretë i këtij Grupi se neni 10 i ligjit të përmendur bije ndesh me nenin 27 të ligjit kushtetues “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”, që parashikon se askujt nuk mund t’i mohohet e drejta të ketë pronë private vetëm ose së bashku me të tjerë. Kjo sepse po në këtë nen sqarohet se fitimi, gëzimi dhe tjetërsimi i pronës, si edhe e drejta e trashëgimisë rregullohen me ligj dhe është pikërisht ligji nr.7698, datë 15.4.1993 që ia njeh fitimin dhe gëzimin e pronës ish-pronarit që nga data 29 nëntor 1944. Kështu që parimi kushtetues se askujt nuk mund t’i mohohet e drejta të ketë pronë, mbrohet në radhë të parë ish-pronarin që shteti i mëparshëm e zhveshi nga pronësia në mënyrë të padrejtë.

Përsa i përket kërkesës së dy shtetasve të mësipërm, rezulton se këta në pronat e blera nga shteti kanë bërë shtesa dhe shpenzime. Këto raste rregullohen me nenin 13 të ligjit të lartpërmendur, për të cilin Gjykata Kushtetuese është shprehur një herë me vendimin nr.7, datë 14.9.1994, duke vendosur se nuk vjen në kundërshtim me ndonjë dispozitë kushtetuese dhe se pajtohet plotësisht me dispozitat e çdo legjislacioni civil, të cilat ndalojnë përfitimet pasurore të papërligjura.

Përsa i përket shpenzimeve të pretenduara, problemi nuk është në kompetencën e kësaj Gjykate.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 pika 2, 25 e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, si edhe të kërkesave të qytetarëve Selim Qaflehi e Marjeta Vuka, për shfuqizimin e nenit 10 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Votoi kundër këtij vendimi zoti Veli Budo.

MENDIMI I PAKICES

Jam kundër vendimit të shumicës për këto arsye :

1. Themeli i këtij vendimi është qëndrimi se pas shfuqizimit të Kushtetutës të vitit 1976 pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe veçanërisht pas shpalljes së ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, shteti zhvishet automatikisht dhe menjëherë nga cilësia e tij si pronar i pronave të ish-pronarëve dhe ish-pronarët bëhen automatikisht pronarë të ish-pronave të tyre.

Një gjë e tillë nuk i përgjigjet të vërtetës mbasi deri në ditën që komisioni për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve merr vendimin in concreto për kthimin e pronave këtij ose atij ish-pronari, ato figurojnë të hipotekuar në emër të shtetit pa asnjë barrë, ky i fundit me cilësinë e tij si trashëgimtar i vetëm publik i shtetit të mëparshëm. Është e natyrshme që ky arsyetim i shumicës ka parapërcaktuar edhe fatin e vetë vendimit në tërësinë e tij.

2. Diktatura komuniste shpronësoi në mënyrë sistematike ish-pronarët nga pronat e tyre, ndërtesa, godina, ngrehina, shtëpi banimi etj. Dhe këto veprime arbitrare të “pushtetit popullor” ai i sanksionoi me ligjet e nxjerra njëri pas tjetrit për shpronësimin e “shpronësuesve”.

Në vijim të kësaj shteti si “pronar i ligjshëm”, këto shtëpi të marra në mënyrë të padrejtë si pasojë e zbatimit të të famshmit parim të zhvillimit të luftës së klasave, ua shiti pronarëve të ndryshëm.

Pa dyshim ndër blerësit kanë qenë edhe nga ata që janë bërë pronarë të këtyre shtëpive si

pasojë e shfrytëzimit të pozitës së tyre zyrtare si funksionarë, si ish-drejtues të partisë dhe pushtetit komunist. Por është e vërtetë gjithashtu se edhe një numër blerësish punëtorë apo nëpunës të thjeshtë kanë blerë të tilla. Më vonë dikush nga këta blerës i ka tjetërsuar këto shtëpi ndër persona të tretë e në vazhdim.

Tashti kërkohet që edhe këta persona të cilët i besuan këtij shteti pronar i madh që t'i hapnin sytë e t'i bënin katër dhe të shikonin në se këto banesa, që figuronin ligjërisht si pronë e shtetit, e kishin ose jo prejardhjen nga prona private dhe u ishte marrë në mënyrë të padrejtë ish-pronarëve të atëhershëm.

Të mendosh në këtë mënyrë sot dhe t'i quash veprimet e tyre si të gabuara nuk është shumë e vështirë, por unë mendoj se sjelljet dhe qëndrimet e njerëzve duhen parë me syrin e kohës dhe të maten me kutin e kushteve dhe rrethanave në të cilat atëherë u kryen këto veprime juridike. Aq më tepër për rastet kur këto ndërtesa kanë kaluar në pronësi nga blerësi i parë, në atë të dytë, të tretë etj. Ky i fundit nuk mund të pranohet se përpara se ta blinte ishte i detyruar të hetonte prejardhjen fillestare të kësaj pasurie.

Në këtë rast dyhet patur parasysh se një numër godinash në atë kohë janë shpronësuar për arsye të mos shlyerjes nga ana e pronarëve të tyre të tatimit të jashtëzakonshëm të vënë personave që gjatë luftës kishin spekuluar duke përfituar nga mungesa e mallrave të konsumit duke u pasuruar në mënyrë të paligjshme apo për shlyerjen e dëmit pësuar shtetit si pasojë e vjedhjes nga ana e pronarit të pasurisë shtetërore.

Është e drejtë e padiskutueshme që këta ish-pronarë janë dëmtuar pa të drejtë, por gjithashtu duhet patur parasysh edhe fakti tjetër se edhe pronarët e rinj, që kanë me dhjetra e dhjetra vjet që janë bërë pronarë të këtyre shtëpive, veçanërisht personat e tretë, edhe ata nuk kanë asnjë faj.

Shteti i ri demokratik nuk ka të drejtë të riparojë një padrejtësi bërë një numri personash, duke i bërë një padrejtësi një numri tjetër personash.

Për mendimin tim më e drejtë do të ishte jo zbatimi në mënyrë globale të përmbytjes të nenit 10 të ligjit në fjalë, por shqyrtimi në rrugë gjyqësore i çdo rasti konkret. Çështja mund të gjente zgjidhje edhe duke ua kompensuar ish-pronarëve ndërtesën e marrë padrejtësisht me një ndërtesë tjetër pronë shtetërore ose me pëlqimin e palëve mund të gjente zgjidhje edhe në mënyrë tjetër.

Por Gjykata Kushtetuese mund të vepronte edhe ndryshe. Ajo mund t'i propozonte Kuvendit Popullor bërjen e një formulimi më të drejtë të nenit 10 të ligjit "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

A N Ë T A R
Veli Budo

Tiranë, më 30.11.1994